

STATUT  
i  
**Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (sh.p.k.)**

**"E-NOVA TIRANA"**

**KAPITULLI I**

**Emri, Forma , Selia, Kohezgjatja**

**Neni 1.**                   **Emri**

- 1.1 Emri i Shoqerise eshte "E-NOVA TIRANA" (Shoqeria), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "shpk", cili perfaqeson formen ligjore te saj.
- 1.2 Ortaket e Shoqerise ("Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaquesuar ne kuota.
- 1.3 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :
  - fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "sh.p.k.".
  - Numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
  - adresa e regjistruar ,dhe
  - dhe pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

**Neni 2.**                   **Forma Ligjore**

- 2.1. Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"(Ligji i Shoqerive).

**Neni 3.**                   **Selia**

- 3.1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen **Bulevardi "Bajram Curri" Nd.110,H.18 Ap 1, Njesia Administrative Nr. 5, 1022 Tirane, Shqiperi**. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adresë dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
- 3.2. Selia e Shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 4.** Kohezgjatja

4.1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

**KAPITULLI II**

**Objekti**

**Neni 5.** Objekti i Shoqerise

5.1 Import dhe Eksport ,Ndërtimi i impianteve te energjisë së rinovalueshme dhe prodhimi i energjise te rinovalueshme . Kryerja e veprimeve tregtare, industriale të çdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe/ose përbushjen e objektivit të Shoqërisë, të cilat nuk ndryshojnë veprimtarinë parësore të Shoqërisë dhe nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 6.** Ndryshime

6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

**KAPITULLI III**

**Kapitali Themeltar; Pjeset e Kapitalit Themeltar**

**Neni 7.** Kapitali Themeltar

7.1. Kapitali i Shoqerise do te jete ne total 100 000 (Nje qinde mijë leke), i ndare ne 1 (Nje) kuote, plotesisht te nenshkuara dhe te shlyera nga Ortaku Themelues

**Neni 8.** Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat e zoteruara prej Ortakeve

8.1. Ortaku i Vetem i Shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri eshte si meposhte:

**"E-NOVA" Srl** , nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar , e themeluar sipas ligjeve te Italise , me numer biznesi **12091611009** dhe me Adrese ne Monte Compatri , Via Santa Maria Di Torre Jacua 63 Cap 00040 (RM) (**ORTAKU I VETEM**)

**Neni 9.**

**Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

- 9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjt te shoqerive.
- 9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.
- 9.3. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkuhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotesisht.
- 9.4. Zmadhimi i kapitalit nuk do te dobesoje pjeset e interesit te Ortakeve ne Kapitalin e shoqerise, pervecse kur Ortaket do te bien dakord ndryshe me vendim unanim te Ortakeve.
- 9.5. Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizoje Administratorin(et) te bejne blerjen e kuotave perkatese dhe ti anullojne ato.

**Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

- 10.1. Ortake jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.
- 10.2. Cdo kuote i jep te drejten e nje vote cdo Ortaku, ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjithshme), te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, per cdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjt te Shoqerive.
- 10.3. Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.
- 10.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.

- 10.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne perjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne; Ortaket nuk mbajne perjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne ).
- 10.6. Shoqeria nuk mban perjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

**Neni 11. Transferimi i pjeseve te Kapitalit**

- 11.1. Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.
- 11.2. Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme ndonje, disa ose te gjithe kuotat e tij ("Shitesi"), ai duhet qe te marre paraprakisht miratimin e Asamblese se Pergjithshme e cila duhet te vendose me nje shumice qe perfaqeson te pakten 75 % (shtatedhjete e pese perqind).
- 11.3. Shitesi duhet t'i jape Perfituesit nje njoftim me shkrim ("Njoftimi i Shitesit") ne lidhje me qellimin e tij per te shitur nje pjese ose gjitha kuotat. Ne njoftimin e tij, Shitesi do te informoje Perfituesin ne lidhje me:
  - numrin e kuotave qe Shitesi deshiron te shese,
  - cmimin, dhe
  - dispozitat dhe kushtet e shitjes.
- 11.4. Perfituesi duhet qe brenda 90 (nentedhjete) diteve nga dita e neserme e dites kur Njoftimi i Shitesit i jepet Perfituesit, t'i jape nje perjigje me shkrim Shitesit, ("Pergjigja e Perfituesit"), ne lidhje me qellim per te blere apo refuzuar blerjen e kuotave te ofruara sipas cmimit dhe kushteve te percaktuara ne Njoftimin e Shitesit. Nese Perfituesi nuk njofton ne menyren e duhur Shitesin, Perfituesi do te konsiderohet qe ka refuzuar blerjen e Kuotave te Ofruara.
- 11.5. Nuk lejohet e drejta e parablerjes te pjeseshme.
- 11.6. Nese Perfituesi tjeter vendos te bleje kuotat e propozuara, Shitesi dhe Perfituesi duhet qe brenda 15 (pesembedhjete) diteve bankare nga dita e neserme e dites kur Pergjigja e Perfituesit i jepet Shitesit, te hyjne ne nje marreveshje te detyrueshme shit-blerjeje kuotash perpara nje noteri publik. Shitesi eshte i detyruar qe te shese kuotat e ofruara me cmimin dhe sipas dispozitave dhe kushteve te percaktuara ne Njoftimin e Shitesit.
- 11.7. Nese Perfituesi kundershton ose konsiderohet se ka kundershtuar te bleje kuotat e ofruara qe nga kjo dite Shitesi eshte i lire te shese kuotat e ofruara nje pale te trete, por vetem:

- me nje çmim te barabarte ose me te larte sesa cmimi i parashikuar ne Njoftimin e Shitjes dhe sipas miratimit te gjithe kushteve te Ortakeve te tjere, sic parashikohet ne Njoftimin e Shitjes; dhe
  - nese pala blerese pranon te behet pale dhe per rrjedhoje t'i permbahet kushteve te Statutit te Shoqerise apo cdo marreveshjeje ekzistuese midis Ortakeve.
- 11.8. Shitesi do t'i jape Perfituesit nje kopje te marreveshjes se shitblerjes te perfunduar me palen e trete per shitjen e kuotave te ofruara.
- 11.9 Nese kuotat e ofruara nuk shiten brenda 30 (tridhejete) diteve nga dita e neserme e dites kur Shitesi eshte i lire te shese kuotat e ofruara nje pale te trete, atehere e drejta e parablerjes e Ortakut tjeter do te riperterihet ne lidhje me kuotat e ofruara ne te njejten gjendje siç ishte perpara se kuotat te ofroheshin per shitje.
- 11.10. Krijohet nje "Liber i Ortakeve" ku te gjithe Ortaket mund te regjistrojne kuotat qe ato zoterojne ne Shoqeri. Ne menyre qe te konsiderohen si Ortake, cdo person qe siguron zoterimin e nje ose me shume kuota te Shoqerise duhet e regjistroje emrin ne Librin e Ortakeve.
- 11.11. Cdo hyrje ne liber do te treguje emrin e Ortakut, shumen e kuotes qe nje Ortak i caktuar zoteron dhe formen e transaksionit nepermjet se ciles eshte siguruar ky zoterim. Libri mbahet nga Administratori(et) e Shoqerise, te cilet duhet t'i leshojne nje kopje te njejte secilit Ortak qe e kerkon. Cdo hyrje ne liber regjistrohet dhe nenshkruhet nga Administratori(et) i/e Shoqerise, pasi te paraqitet nga Ortaku perkates dokumenti qe verteton zoterimin e kuotave prej tij.
- 11.12 Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit.

#### **KAPITULLI IV** **Asambleja e Pergjithshme**

##### **Neni 12.      Kompetencat**

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 12.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose me nje shumice qe perfaqeson te pakten 75% (shtatedhjete e pese per qind) te kapitalit te Shoqerise ("Shumica e Kualifikuar") ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:

- aprovin e strategjise se Shoqerise, Planit te Biznesit, planeve finaciare dhe buxhetit;
- aprovin e cdo ndryshimi ne vijim ne Planin e Biznesit te Shoqerise dhe ne planet financiare;
- shperndarjen e fitimeve;
- pezullimin e aktivitetit te Shoqerise dhe/ose perfundimin, shperberjen apo likuidimin e Shoqerise;
- ndryshimet, amendimet apo zevendesimet ne aktin e themelimit dhe statutin e Shoqerise;
- ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;
- ndryshimin e selise se shoqerise.
- prezantimin e cdo kerkese per likuidim apo falimentim;
- krijimin e filialeve;
- strukturen e brendshme dhe organizimin e Shoqerise;
- bashkimin me shoqeri te tjera, apo ndarjen dhe shkeputjen e Shoqerise;
- vleresimin e kontributeve ne natyre, ne mungese te eksperteve vleresues te emeruar, sipas Nenit 68 te Ligjit te Shoqerive;
- zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
- cdo investim te Shoqerise, shpenzim dhe detyrim qe tejkalon kufije e vendosura kohe pas kohe nepermjet vendimeve te Ortakeve;
- zvogelimin e kufijve per te cilat kerkohet aprovimi i shumices se kualifikuar te Ortakeve.

**12.3** Ne rastet kur vendimi nuk mund te kalohet per shkak se nuk arrihet Shumica e Kualifikuar, kjo nuk duhet te konsiderohet si situate e pazgjidhshme, dhe Ortaket duhet te lejojne per kete qellim nje periudhe reflektimi prej 14 (katermbedhjete) ditesh. Ne diten e 15 (pesembedhjete) Ortaket takohen serish dhe perpiqen te bien dakord per miratimin e vendimit ose, nese eshte i aplikueshem, cdo vendimi alternativ, me Shumice te Kualifikuar. Nese serish, Ortaket nuk arrijne te vendosin me shumice te kualifikuar, atehere zbatohet "zgjidhja emergjente" dhe vendimi miratohet me shumice te thjeshte te votave (dmth 75 %). Zgjidhja emergjente mund te aplikohet vetem ne lidhje me paragrafin (i), (ii), (xiii) dhe (xiv) te Seksionit 12.2.

**12.4** Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose me shumice te thjeshte votash dmth 75 % ne lidhje me te gjitha ceshtjet e tjera te Shoqerise qe jane te specifikuara ne nenin 81 te Ligjit per Shoqerite, te listuara si me poshte:

- (i) emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (ii) percaktimi i shperblimit te auditoreve dhe likuiduesve;

- mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori (et) i/e Shoqerise, perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- perfaqesimin e Shoqerise perpara Gjykates si dhe ne ceshtjet gjyquesore kunder Administratorit(eve); dhe
- ceshtje te tjera te cilat do te parashikohen nga Ortaket.

#### **Neni 13. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme**

- Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.
- Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane një vlerë me te larte se 5% e te gjithe aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjesë ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga një ortak pasuri, qe kane vlerë me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjesë ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- Ortaket do te organizojne takime me Administratorin(et) cdo tre muaj me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratori(et) gjate ketij tre mujori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre.
- Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje një rezolute keshilluese , duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

#### **Neni 14. Menyra e Thirrjes**

- Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e paraqitura ne nenet e mesiperme 12 dhe 13, nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.
- Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga Administratori (et) ose nga cdo njeri prej Ortakeve.
- Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te Tiranës, Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe axhenda perkatese e mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Persa i perket vendimeve qe merren jashte Republikes se Shqiperise, Administratorit(eve) u vihet te dispozicion nje kopje e shkruar e ketyre vendimeve te cilen Administrator(et) e ruajne ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise, qe mbahet ne seline e Shoqerise, nen kujdesin e Administratorit(eve). Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithe ortaket bien dakort.
- Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.
- Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundershtite e tyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne ate Administratorit(eve) te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet nga shumica e kerkuar ne perputhje me Seksionin 12, me siper.
- Secili prej Ortakeve ka te drejten e te pakten 1 vote; cdo kuote perfaqeson nje vote.
- Vendimet e Ortakeve te marra ne perputhje me kete statut si dhe me Ligjin per Shoqerite do te jene te detyrueshme per Shoqerine. Cdo vendim i itille mund te merret gjithashtu jashte territorit te Republikes se Shqiperise, dhe evidence me

shkrim e ketij vendimi do t'i dorezohet Administratorit(ve) qe do ta regjistroje ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise.

- Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostilimit, ne varesi te vendit ku leshohen).
- Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.
- Administratori (et) duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

**Neni 15      Perjashtimi nga e drejta e votes**

- Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:
    - (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
    - (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
    - (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
    - (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
- 15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaquesuar nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes i sikunder ortaku te cilin perfaqeson.

**KAPITULLI V**

**Administrimi dhe Perfaqesimi**

**Neni 16.      Administratori (et) dhe kompetencat**

- 16.1 Shoqeria drejtohet dhe perfaquesohet nga Administratori (et). Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.
- 16.2 Administratore dhe Perfaquesues Ligjore te Shoqerise do te jene dhe do te veprojne ne menyre te pavarur nga njeri tjetri :

**SANTI CRISAFI ,i lindur me 21/08/ 1981 ne Regio Calabria ,Itali dhe me kombesi Italiane, mbajtese i Pasaportes me Numer YB6146100**

**ANIELLO AMBROSIO , i lindur me 08/05/1980 ne Napoli ,Itali me kombesi Italiane, mbajtes i Pasaportes me Numer YB5420312**

- 16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratorit (eve) eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore(dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), me te drejte riperteritje te ketij mandati.
- 16.4 Cdo Ortak ka te drejte qe te propozoje nje nga Administratoret. Administratori (et) zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ne perputhje me nenin 12.4, me siper, dhe/ose nga marreveshja e Ortakeve.
- 16.5 Menjehere pas pranimit te emerimit, Administratori(et) njojin ne forme te shkruar se mardhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohet si arsy e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.
- 16.6 Ortaku/Ortaket kane te drejten te shkarkojne Adminsitratorin (et) me shumice te thjeshte votash. Ne rast shkarkimi te njerit dhe/ose te gjithe Administratoreve, Administratori(et) e rinj do te emerohen sipas procedures se pershkruar ne Seksion 16.5 dhe marreveshjes se Ortakeve.
- 16.7 Administratori (et) vepron ne lidhje me cdo ceshtje te Shoquerise qe nuk eshte caktuar nen autoritetin e Ortakeve ne perputhje me kete Statut, dhe cdo apo te gjithe vendimeve te Ortakeve si dhe ligjeve te zbatueshme.
- 16.8 Nese Shoqeria do te kete me shume se nje Administrator dhe ato nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, ceshtja do te referohet tek Ortaket te cilet vendosin ne perputhje me Seksionin 12, ne varesi te ceshtjes qe do te shqyrtohet.
- 16.9 Nese Shoqeria do te kete me shume se nje Administrator dhe ato nuk arrijne te vendosin se bashku, ne nje mase te tille sa Ortaket te gjykojne qe kjo mosmarreveshje e vazhdueshme pengon seriozisht operimin normal te aktivitetit te Shoquerise, Ortaket me shumice te thjeshte te votave vendosin per zevendesimin e njerit ose te te dy Administratoreve. Administratori(et) pasues emerohen ne perputhje me Seksionin 16.5 dhe me marreveshje te Ortakeve.

- 16.10 Shpenzimet e xhepit te justikuara ne menyre te arsyeshme nga Administratori(et) dhe te kryera ne funksion te mbarevajtjes se operimit te Shoqerise rimbursohen nga Shoqeria.
- 16.11 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimburson Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Administratorit(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

**Neni 17      Kompetencat dhe detyrimet**

- 17.1 Kompetencat e Administratorit (eve) ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 13.
- Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- Perfaqesimin e Shoqerise.
- Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.
- Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme.
- Krijimin e nje sistemi paralajmerimi per irrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- Kur eshte e nevojshme, kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe ose organeve te tjera, personalisht ose nepermjet te autorizuarve nga ai.
- Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

17.2 Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lindhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

#### **Neni 18      Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia**

- Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise,sipas neneve 14,15,16,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, Administratori (et) detyrohen:
  - (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
  - (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
  - (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
    - te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
    - te garantoje miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te nenit 13 te Ligjit te shoqerive;
    - te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem
- Administratori (et) gjate kryerjes se detyrave te tyre per gjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.
- Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori (et) eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve.Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata per gjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
- Ne vecanti, Administratori (et) eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine,per demet, neqoftese ne kundershtim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e me poshtme:
  - i kthen Ortakeve kontributet;

- i paguan Ortakeve interesa apo dividente;
- i shperndan asetet Shoqerise;
- lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
- jep hua

## KAPITULLI VI

### Administrimi Financiar i Shoqerise

#### **Neni 19. Eksperti Kontabel i Autorizuar**

- 19.1 Nese kerkohet, Ortaket duhet te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgatjen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## KAPITULLI VII

### Aktiviteti Shoqerise

#### **Neni 20. Viti ekonomiko-financiar**

- 20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne diten e pare te muajit Janar dhe perfundon ne diten e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne daten e themelimit te Shoqerise.

#### **Neni 21. Mbajtja e Llogarive**

- 21.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

#### **Neni 22. Llogaritja dhe Shprendarja e Fitimit**

- 22.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

- 22.2 Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fordin rezerve te detyrueshem.
- 22.3 Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:
- asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
  - Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;
  - Administratori (et) lehon nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.
  - Administratori (et) perjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## KAPITULLI VIII

### Modifikimi i Formes Ligjore; Prishja

#### **Neni 23. Modifikimi i Formes Ligjore**

- 23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 12 ketu dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 23.2 Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

#### **Neni 24. Prishja e Shoqerise**

- 24.1 Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

- si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- hapje e nje procedure falimentimi;
- nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";

- me vendim gjykate;
  - per arsyte tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.
- 24.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

## **KAPITULLI IX**

### **Te ndryshme**

#### **Neni 25. Largimi i Ortakut**

- 25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive

#### **Neni 26 Ligji i zbatueshem**

- 26.1 Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet shqiptare.

#### **Neni 27. Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

- 27.1 Mosmarrveshjet që mund tē lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

#### **Neni 28 Kofindencialiteti, ruajtja e sekretit dhe maredheniet e punes**

- 28.1 Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga Administratori(et) dhe/ ose Ortaket e kesaj shoqerie.
- 28.2 Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesarit jane te detyruar qe te respektojnë Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Neni 29      Librat e shoqerise**


- 29.1 Pervec sa percaktohet ne legjislacion Shoqeria mban librat e me poshtem:
- (i) Libri i Ortakeve
  - (ii) Libri i Mbledhjeve
  - (iii) Libri i vendimeve te Asamblese se Pergjithshme dhe Administratorit (eve)
  - (iv) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.
- 29.2 Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jetë e vulosur.

**Neni 30      Te tjera**

- 30.1 Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite dhe legjislacioni shqipetar ne fuqi.
- 30.2 Ky statut hartohet dhe nenshkruhet nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, sot me date 10 Korrik 2024 ne gjuhen shqipe ne kater kopje.

**NE EMER DHE PER LLOGARI TE  
ORTAKUT TE VETEM**

Z.SANTI CRISAFI

 Santi Crisafi

Z. ANIELLO AMBROSIO

 Antonio Ambrosio